



KONTRATË – PUNË

TITULLI I KONTRATËS

01.370/02-0076450/22
10.08.2022
Mitrovicë - Mitrovica

Renovimi i Objektivit të SHFMU-së SKENDERBEU në Vaganicë-
Renovimi i Palestres-Lloti i I-rë .

Nr ¹ i prokurimit	642-22-4341-5-2-1
Nr i brendshëm	642/22/014/521

10/08/2022 Mitrovicë e JUGUT

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**PJESA B: KONTRATA 2 & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E
NDËRLIDHURA**

PJESA E KONTRATËS: KONTRATË PUNE.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate është ekzekutimi i punëve në çmimet e ofruara për njësi dhe në total dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve si në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**Renovimi i Objektivit të SHFMU-së SKENDERBEU në Vaganicë-
Renovimi i Palestres-Llota i I-rë**

KOMUNA- MITROVICË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

N.N.P."B-ENGINEERING", BRIGADA 123, SUHAREKË, (në vazhdim
"Kontraktori"), me nr Biznesi UNIK: **811039123** dhe nr Fiskal: **600756540** në
anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë për Punët e cekura si në vijim:

**Renovimi i Objektivit të SHFMU-së SKENDERBEU në Vaganicë-
Renovimi i Palestres-Llota i I-rë**

me numër identifikues: nr i Prokurimit: **642-22-4341-5-2-1**; nr i brendshëm: **642/22/014/521**

Autoriteti kontraktues kryen punë vetëm në emër të vet Komuna e Mitrovicës së JUGUT.

Përdorimi i kësaj kontrate është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetin Kontraktues të Komunën e Mitrovicës të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata hynë në fuqi me : **[15/08/2022] dhe përfundon me 15/12/2022].**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: [68.579,60 €];[Gjashtëdhjetë e temijë e pesëqindë e shtadhjetë e nëntë euro e 60/100] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve. Pagesat do të bëhen brenda periudhës-planit dinamik 120 ditë (4 muaj) sipas raportit të punëve të kryera [nëse situacionet janë brenda afatit faturat mund të dorëzohen edhe pas skadimit të kontratës].

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

A. Kushtet e Veçanta të Kontratës; **B.** Kushtet e Përgjithshme të Kontratës; **C.** Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike; **D.** Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria dhe Identifikimi financiar i O.E.(pjesë e DT).

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [SHQIPE]³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Një(1) Origjinal për Njësin kërkuese (DKA), Një(1) Origjinal për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa,

Një(1) Origjinal për Drejtorinë e Prokurimit dhe Një(1) Origjinal për Kontraktuesin.

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues:	
Komuna e Mitrovicës JUGORE-40000	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	10/08/2022
Vula:	

Për Kontraktorin:	
N.N.P."B-ENGINEERING",BRIGADA 123, SUHAREKË,600756540	
Emri:	Betim MAMAJ
Pozita:	Drejtor
Emajli:	b_mamaj@hotmail.com
NUI:	811039123
Nr i telefonit:	+38349288111
Nënshkrimi:	
Data:	10/08/2022
Vula:	

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEQANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% të vlerës së Kontratës ose 6.857.96 Euro me kohëzgjatje prej 120 ditë ose 4 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [N/A]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [N/A]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [N/A]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit:[N/A] (ii) të personave të tjerë: [N/A]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Azhurnimi-Periudha e Intervenimit	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [1] ditë ose 24 orë pas marrjes së shkresës ose një kërkesë nga ana e AK do të jetë efektiv për intervenim për gabimet ose defektet gjatë kryerjes së punëve.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë [brenda datës 15/08/2022 më largu].
Përfundimi i punëve	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [60 ditë] ose deri më: 15/10/2022.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.05%] për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është [10%] e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit: [Naser RRAHMANI , emajl adresa: [naser.rrahmani@rks-gov.net].
Parapagimi(Avansi)	26.1	Nga A.K. i lejohe O.E. PARAPAGIMI 20 % AVANS sipas Ligjit për Financa Publike për furnizim me material për fillim sa më të shpejtë të punëve.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [N/A]
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [5] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj [365] ditë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët ose të realizojë punët brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së Punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Qdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të punëve të kësaj kontrate është e mundur të zgjidhet në mënyr miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit <u>Kontraktues-Komuna Mitrovicës dhe personat përgjegjës të kontraktorit.</u>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME:

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrenim ndërtesash, pajisje, struktura inxhiniering civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyt e mëposhtme:

a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe

b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm. Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato.

Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve

**KONTRATË PUNË: Titulli: Renovimi i Objektivit të SHFMU-së SKENDERBEU në Vaganicë-
Renovimi i Nyjeve Sanitare -Lloti i II-të...Nr i Prokurimit: 642/22/4341/521; Nr i
Brendshëm: 642/22/014/521.**

të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

(a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose

(b) të ndërpresë kontratën; dhe

(c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i

përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkomporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimi do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

KONTRATË PUNË: Titulli: Renovimi i Objektivit të SHFMU-së SKENDERBEU në Vaganicë-

15

Renovimi i Nyjeve Sanitare -Lloti i II-të...Nr i Prokurimit: 642/22/4341/521; Nr i

Brendshëm: 642/22/014/521.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe

- datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranimit të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsytet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranimit të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre në punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paguesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i

llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përqipen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Nr.	OBJEKTI: Lloti i I-rë--Renovimi i PALESTRËS SHFMU-Skenderbeu.. Përshkrimi i POZICIONEVE:	Njësia matse	Sasia	Qmimi njësi pa TVSH	TVSH	Qmimi njësi me TVSH	TOTALI Gjithsejt me TVSH
1	Punët e Demolimit:						
1.1	Demolimi i te gjitha shtresave ekzistuese te dyshemese se salles (deri ne shtresen rrafshuese) dhe transporti deri ne deponi.	m ²	465	8.47	1.53	10.00	4,650.00 €
1.2	Largimi i te gjitha pajisjeve te levizshme nga salla deri ne perfundim te punimeve ne nje hapesire tjeter, ndersa ne bashkepunim me personelin e shkolles ato mjete qe jane te paperdorshme te transportohen deri ne deponi.	paushall	1	847.46	152.54	1000.00	1,000.00 €
1.3	Çmontimi i kabinave ekzistuese te toaleteve (panelet se bashku me dyert), dhe transportimi deri ne deponi.	paushall	1	423.73	76.27	500.00	500.00 €
1.4	Çmontimi dhe transporti deri ne deponi i te gjitha elementeve te toaletit (lavamana, guaska te WC-se , pisoaret me te gjitha pjeset percjellese).	cope	19	16.95	3.05	20.00	380.00 €
1.5	Çmontimi i te gjitha dyerve te drurit ne kuader te hapesirave te salles dhe toaletit si dhe transporti deri ne deponi.	cope	11	12.71	2.29	15.00	165.00 €
1.6	Çmontimi i pllakave te qeramikes te mureve te toaletit dhe kthinave tjera dhe transporti deri ne deponi.	paushall					- €
1.7	Gerryerja e suvatimit ne cokllen e salles deri ne sipërfaqen e betonit.	m'	67	2.54	0.46	3.00	201.00 €



1.8	Çmontimi i pllakave te Viniflex-it nga dyshemeja e shkalleve - tribunave si dhe dyshemese se ballkonit te salles dhe transporti deri ne deponi .	m ²	110	4.24	0.76	5.00	550.00 €
1.9	Çmontimi i gypit metalik nga dyshemeja deri ne tavan i cili i ka larguar ujerat atmosferike nga kulmi i rrafshet i salles ndersa tani eshte jashte funksionit. Perfundimet te mbyllen me kapak adekuat.	m'	10	4.24	0.76	5.00	50.00 €
Punët e Demolimit:							7,496.00 €
2 Punët e Dyshemesë:							
2.1	Punimi i dyshemesë notuese ne sallën e edukates fizike nga parketi i bungut të Kl - I - rë me trashesi t= 24mm. Ne kete pozicion eshte i perfshire i gjithë nenkonstrukioni i drurit qe mundeson amortizimin e goditjeve dhe shtruarja paraprake e dyshemese me iver pllaka. Gerryerje dhe lyerje me llak pa ngjyrë. Në llogari të merren elementi skajor dhe te gjitha elementet tjera te nevojshme per kete lloj dyshemeje . Llogaria ne m2 te siperfaqes se punuar. <i>Verejtje : Perfundimi i dyshemese afer mureve te fasades se salles te mbyllet me kendoren adekuate nga druri me prerje te valezuar per te lejuar ajrimin e nenshtresave te dyshemese</i>	m ²	465	46.61	8.39	55.00	25,575.00 €
Punët e Dyshemesë:							25,575.00 €
3 Punët e Suvatimit:							



3.1	Suvatimi i mureve të brendëshme nga tulla e fasades (te ndertuara pas luftes) ne sallën e edukates fizike, me llaq vazhdues , raporti 1:2 , me nje shtrese me trashesi prej 15 mm dhe me shtrese paraprake qumeshti te cimentos. Llogaritja ne m2 te suvatimit.	m ²	18	21.19	3.81	25.00	450.00 €
3.2	Suvatimi i coklles se salles me suvatim "Terraco"dhe llac te cimentos. Coklla me lartesi prej h= 60cm. Raporti i perberesve 1:2, dhe me shtrese paraprake qumeshti te cimentos. Ne skaje te coklles te perdoret kendorja metalike. Llogaritja te behet per m' te coklles.	m'	67	8.47	1.53	10.00	670.00 €
3.3	Trau horizontal ne lartesi prej 3.3m nga dyshemeja dhe gjeresi prej h=60cm te salla e edukates fizike te suvatohet me shtrese prej Glet-Gipsi me trashesi 2-3 mm . Ne dy skajet e traut horizontal te perdoret kendorja metalike per formimin e skajit te traut. Llogaria te behet per m' te traut .	m'	67	8.47	1.53	10.00	670.00 €
3.4	Pjesa e shtyllave konstruktive te salles nga dyshemeja deri te trau i pare horizontal ne lartesi prej 3.3m , te perpunohen me suvatim llaq te cimentos me sperkatje paraprake nga qumeshti i cimentos . Raporti i perberesve 1:2. Llogaria te behet per m' te shtyllës .	m'	21	4.24	0.76	5.00	105.00 €



3.5	Suvatimi i murit (parapetit) qe ndane dyshemene e salles me shkallet (tribunat) nga te dy anet e tij me Glet me trashesi deri 2mm. Ne anen e eperme te murit te largohet brinakja e drurit e demtuar dhe te vendoset brinakja e re ne tere gjatesin e murit me dimensione te njejta me ate ekzistuese. (perforcimi te behet duke perdorur pjese metalike , vida - tiplla).	m ²	43	4.24	0.76	5.00	215.00 €
3.6	Vendosja e kendoreve metalike per formimin e skajit te murit neper te gjitha dritaret (salles dhe toaletit) bashke me gletimin e saj .	m'	160	1.69	0.31	2.00	320.00 €
3.7	Rreth dritareve te salles dhe toaletit aty ku eshte demtuar shkuma "PurPen" te mbyllet me shkumen e re si dhe te vendosen kendore te aluminit neper tere gjatesine e dritareve .	m'	230	2.54	0.46	3.00	690.00 €
Punët e Suvatimit:							3,120.00 €
4	Punët e Zdrëktarisë:						



4.1	<p>Furnizimi dhe montimi i dyerve prej profileve te Aluminit me nderprerje termike, trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m',sipas DIN, EN ose ISO standardeve. Paneli senduiq kompatibil me profilet . Pjesa e mbindriqimit te plotesohet me qelq te rrjetezuar t=4 mm te kualitetit te larte dhe pa hapje (fixe). Dy dyerve te hyrjes ne toalete (mashkuj dhe femra dhe toaletit ne hapesiren e arsintareve t'iu vendoset pragu ne dysheme ndersa dyert tjera te jene pa pragun ne dysheme. Pas vendosjes se dyerve siperfaqja e mureve te demtuara ne te dy anet e deres te perpunohet - gletohet ne menyre adekuate duke perdorur edhe kendoret nga alumini. Llogaria ne cope te deres se montuar.</p> <p><i>Verejtje : Me poshte jane dhene dimensionet e peraferta te dyerve , ndersa dimensionet e sakta te merren pas largimit te dyerve ekzistuese, (hapesira e paster ne mes te mureve si dhe nga dyshemeja deri ne tavan).</i></p>						
	155 / 265 cm (me mbindriqim)	cope	1	296.61	53.39	350.00	350.00 €
	100 / 265 cm (me mbindriqim)	cope	2	296.61	53.39	350.00	700.00 €
	90 / 265 cm (me mbindriqim)	cope	5	254.24	45.76	300.00	1,500.00 €
	80 / 265 cm (me mbindriqim)	cope	1	254.24	45.76	300.00	300.00 €



<p>4.2 Furnizimi dhe montimi i dyerve bashke me panelet ndarëse ne toalete prej profileve te Aluminit, trashësi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m', sipas DIN, EN ose ISO standardeve me dimensione dhe hapje te ndryshme . Dyert të pajisen me mekanizëm përkatës për hapje-mbyllje, ramin, bravën te kualitetit te larte. Sipërfaqja ne mes te profileve te plotësohet me panel senduiq. Panelet te prodhohen nga materiali kompatibil sikurse dyert, ndersa te jene te ngritura nga dyshemeja finale 200mm, ankerimi i profilit te aluminit ne dysheme dhe mure te jete solid. Dimensionet e kabines : 100 x 120 x 205 cm. Llogaritja ne cope te derës\kabinës te montuar.</p> <p><i>Verejtje : Dimensionet dhe vendosja e kabinave te jene ne pozicione te njejta ashtu siq jane ato ekzistuese sepse edhe kyqjet e guacave te WC-se ne rrjetin e ujesjellesit dhe kanalizimit duhet te behet ne pozicionet ekzistuese.</i></p>	cope	6	423.73	76.27	500.00	3,000.00 €
--	------	---	--------	-------	--------	------------

Official stamp of the Ministry of Health of Albania, with a handwritten signature over it.

4.3	Furnizimi dhe montimi i vitrines prej profileve te Aluminit me nderprerje termike, trashesi te mureve te profilit t=1.5 mm dhe peshe specifike 1.8kg/m ² , sipas DIN, EN ose ISO standardeve. Dim. 265 x 305cm. Paneli senduiq kompatibil me profilet dhe me lartesi h= 200cm nga dyshemeja, pjesa tjeter deri ne tavan te plotesohet me qelq termoizolues d=4+12+4 mm te kualitetit te larte, llojit FLOAT . Llogaria ne cope te vitrines se montuar.	cope	1	296.61	53.39	350.00	350.00 €
Punët e Zdruktarisë:							6,200.00 €
5 Punët e Keramikës:							
5.1	Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës (të klasit të parë) me ngjitës në dysheme te toaleteve, garderobave, koridore dhe kthinat tjera, (mbi pllakat ekzistuese duke perdorur paraprakisht bazen - emulzionin per krijimin e lidhjes ne mes te materjaleve). Vendosja e pllakave ne dysheme te behet pa fuga (fuge prej 1 mm e lejuar), lloji dhe ngjyra e pllakave caktohet sipas kërkesës së investitorit. Perpos ne toalete ne te gjitha hapesirat tjera te vendosen pllakat (bordurat) ne mur ne lartesi prej 10cm ne ato kthina ku muret nuk mvshen me pllake keramike . Llogaria ne m ² te siperfaqes se punuar. <i>Verejtje : Vija e bashkimit ne mes te dyshemese se re dhe dyshemese se vjeter te ekzekutohet me pjerrtesi (jo me shkallezim) . Ujembledhesit e ri ne toalete te ngriten ne nivelin e dyshemese se re .</i>	m ²	81	16.95	3.05	20.00	1,620.00 €



<p>5.2 Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës (të klasit të parë) me ngjitës në muret e toaleteve . Vendosija e pllakave ne mure te behet pa fuga (fuge prej 1 mm e lejuar), lloji dhe ngjyra e pllakave caktohet sipas kërkesës së investitorit. Paraprakisht te nivelizohet sipërfaqja e murit te demtuar gjate demollimit te pllakave ekzistuese . Pllakat te vendosen ne lartesine prej 180cm nga dyshemeja e toaleteve . Ne llogari hyn edhe vendosja e kendoreve nga alumini. Llogaria per m2 te sipërfaqes se punuar.</p>	m ²	82	16.95	2.71	20.00	1,640.00 €
<p>5.3 Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës (të klasit të parë) me ngjitës në shkallet e hyrjes ne salle bashke me pushimoren (ne te dy anet e salles) . Vendosija e pllakave ne shkalle te behet pa fuga (fuge prej 1 mm e lejuar), lloji dhe ngjyra e pllakave caktohet sipas kërkesës së investitorit. Ne llogari hyn edhe vendosja e kendoreve nga alumini ne skajet e shkalleve. Llogaria per m' te sipërfaqes se punuar.</p>	m'	8	8.47	1.36	10.00	80.00 €
<p>5.4 Furnizimi dhe mveshja e shkalleve te salles per shikues me linoleum . Vendosija te behet sipas udhezimeve te prodhuesit duke perdorur edhe kendoret adekuate. Dimensionet e shkalleve jane me gjeresi prej 0.8m dhe gjatesi prej 20m . Paraprakisht te behet sanimi i pjeseve te demtuara .Llogaria per m' te sipërfaqes se punuar .</p>	m'	80	22.88	3.66	27.00	2,160.00 €
Punët e Keramikës:						5,500.00 €
6 Punët e Ngjyrosjes:						



<p>6.1 Furnizimi me material, ngjyrosja me ngjyre te yndyrshme i mureve (ne kuader te salles) ne dy shtresa (impregnimin sipas nevojës), mbi shtresen bazë të klasit të parë. Ne kete siperfaqe hynë ngjyrosja e murit te fasades se salles i cili eshte rindertuar pas lufte. Ky mur eshte kalkuluar edhe te pozicioni per suvatim . Paraprakisht ne vendet me shume te demtuara dhe ne plasaritjet e mureve te behet gjetimi i tyre . Lloji dhe ngjyra caktohen sipas kerkeses se investitorit . Llogaria per m2 te siperfaqes se punuar.</p>	m ²	325	2.54	0.46	3.00	975.00 €
<p>6.2 Furnizimi me material, ngjyrosja me ngjyre te yndyrshme i mureve ne hapësirat e garderoberes dhe toaletesve ne dy shtresa (impregnimin sipas nevojës), mbi shtresen bazë të klasit të parë. Ne hapësirat e toaletesve ngjyrosja te behet nga perfundimi i pllakave te keramikes deri ne tavan . Paraprakisht ne vendet me shume te demtuara dhe ne plasaritjet e mureve te behet gjetimi i tyre . Lloji dhe ngjyra caktohen sipas kerkeses se investitorit . Llogaria per m2 te siperfaqes se punuar.</p>	m ²	304	2.54	0.46	3.00	912.00 €



6.3	Furnizimi dhe ngjyrosja e tavanit me ngjyre akrile (ngjyre jo te yndyrshme) me nje shtrese mbi shtresen bazë të klasit të parë te aplikuar paraprakisht. (Ne llogari hyme sipërfaqja e tavanit te salles, garderobes dhe toaletit). Para aplikimit te ngjyrosjes te pastrohen te gjitha sipërfaqet nga pluhuri dhe papastertite tjera nga tavani. Lloji dhe ngjyra caktohen sipas kerkeses se investitorit . Llogaria per m2 te sipërfaqes se punuar.	m ²	678	2.54	2.50	3.00	2,034.00 €
6.4	Furnizimi dhe ngjyrosja e te gjithe trareve mbajtes nga betonarmeja (salla , garderoba dhe toaleti) me ngjyre akrile (jo e yndyrshme) me nje shtrese mbi shtresen baze te klasit te pare te aplikuar paraprakisht. Ne vendet e demtuara te ngjyres ekzistuese te behet sanimi i saj dhe pergatitja per ngjyrosje. Para aplikimit te ngjyrosjes te pastrohen te gjitha sipërfaqet nga pluhuri dhe papastertite tjera. Lloji dhe ngjyra caktohen sipas kerkeses se investitorit . Llogaria per m2 te sipërfaqes se punuar.	m ²	511	2.54	0.46	3.00	1,533.00 €
6.5	Pastrimi dhe ngjyrosja e mureve nga tullat e fasades ne sallën e edukates fizike me llak pa ngjyre ne nje shtrese . Llogaria per m2 te sipërfaqes se punuar .	m ²	232	2.54	0.46	3.00	696.00 €
Punët e Ngjyrosjes:							6,150.00 €
7	Punët e Elektrikës:						
7.1	Inqizimi i objektit, hulumtimi i prishjeve në instalimet elektrike	paushall	1	211.86	38.14	250.00	250.00 €



7.2	Çmontimi i dritave egzistuese, Furnizimi dhe montimi komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim te dritave fluoescente te tipit me rrjet (per gypa 3 x 18W) .	copë	42	4.24	0.76	5.00	210.00 €
7.3	Furnizimi dhe montimi gypave fluoescente te fuqise 18W , me startera si dhe komplet me pjeset tjera percjellese te nevojshme per montim.	copë	126	8.47	1.53	10.00	1,260.00 €
7.4	Çmontimi i dritave egzistuese, Furnizimi dhe montimi i dritave per montim ne murë(salles se sportive) me poqa te fuqis 60W, komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim.	copë	7	8.47	1.53	10.00	70.00 €
7.5	Furnizimi dhe montimi i poqave elek. te fuqis 60W ne dritat e salles se sportive, per montim ne murë, komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim.	copë	7	8.47	1.53	10.00	70.00 €
7.6	Çmontimi i dritave egzistuese, Furnizimi dhe montimi i dritave me sensor per montim ne tavan, ne kater(4) nyjet sanitare egzistuese-komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim.	copë	12	12.71	2.29	15.00	180.00 €
7.7	Furnizimi dhe montimi i poqave ekonomike te fuqis 20W ne 4 (kater) nyjet sanitare egzistuese, - komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim.	copë	12	12.71	2.29	15.00	180.00 €
7.8	Çmontimi i dritave egzistuese, Furnizimi dhe montimi komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim i dritave fluoescente per gypa 4 x 18W ne nyjen sanitare egzistuese.	copë	4	8.47	1.53	10.00	40.00 €



7.9	Furnizimi dhe montimi gypave fluoesciente te fuqise 18W , ne nyjen sanitare egzistuese. me startera si dhe komplet me pjeset tjera percjellese te nevojshme per montim.	copë	16	12.71	2.29	15.00	240.00 €
7.10.	Çmontimi i nderpreresve egzistues, Furnizimi dhe montimi komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim i nderpreresve ne sallën e sporteve si dhe ne nyjet sanitare egzistuese.	copë	20	8.47	1.53	10.00	200.00 €
7.11	Çmontimi i kutive shperndarese egzistuese, Furnizimi dhe montimi komplet me paimet percjellese te nevojshme per montim te kutive shperndarese ne sallën e sporteve si dhe ne nyjet sanitare egzistuese.	copë	15	12.71	2.29	15.00	225.00 €
7.12	Çmontimi-Ndrimi i siguresave shkrirese ne ormanin shperndares egzistues dhe zevendesimi me siguresa automatike adekuate te xA-ve, Komplet me paimet e nevojshme per funksionalizim te ormanit shperndares per sallën e sporteve.	copë	30	4.24	0.76	5.00	150.00 €
7.13	Çmontimi-riparimi i ormanit shperndares egzistues dhe zevendesimi me elementet e nevojshme- Komplet me paimet e nevojshme per funksionalizim te ormanit shperndares per sallën e sporteve.	copë	1	423.73	76.27	500.00	500.00 €
7.14	Punet tjera te paparapara ne kete paramase e te cilat jane te domosdoshme per kryerjen e ketyre puneve si dhe eliminimi i prishjeve te vrejtura ne instalim	paushall	1	211.86	38.14	250.00	250.00 €
Punët e Elektrikes:							3,825.00 €
8	Punët e Ujësjellshit dhe Kanalizimit:						



8.1	Blerja, transporti dhe montimi i gypave te PE Ø16 mm per uje te ftohte prej kutise shperndarese deri te pikat harxhuese . Eliminimi i rrjetit egzistues te ujesjellesit dhe vendosja e rrjetit te ri brenda murit deri ne pikat ekzisuese te lavamanave, guacave te WC-se, pisoareve, tush kabines etj.	m'	25	2.12	0.38	2.50	62.50 €
8.2	Blerja, transporti dhe montimi i gypave te PE Ø16 mm per uje te nxehte prej kutise shperndarese deri te pikat harxhuese . Eliminimi i rrjetit egzistues te ujesjellesit dhe vendosja e rrjetit te ri brenda murit deri ne pikat ekzisuese te lavamanave, guacave te WC-se, pisoareve, tush kabines etj.	m'	18	2.37	0.43	2.80	50.40 €
8.3	Blerja, transporti dhe montimi i gypave te PE Ø20 per uje te ftohte .	m'	15	2.54	0.46	3.00	45.00 €
8.4	Germimi me dore i dheut per hapjen e kanalit per zevendesimin e gypit ekzisues te kanalizimit per vendosjen e gypit te ri te PVC per kanalizim nga salla deri te puseta para shkalleve te hyrjes ne ndertesen e shkolles.	m'	20	8.47	1.53	10.00	200.00 €
8.5	Blerja, transporti dhe shtruarja e ranes nen dhe anash gypit .	m³	2	16.95	3.05	20.00	40.00 €
8.6	Kthimi i dheut ne kanal ne shtresa me ngjeshje si dhe perfundimi i tij sipas gjendjes paraprake (gjelbrimi dhe dyshemeja e betonit) .	m'	20	1.69	0.31	2.00	40.00 €
8.7	Blerja, transporti dhe montimi i gypit te PVC per kanalizim Ø110, per zevendesimin e gypit egzistues nga puseta para shkalleve te hyrjes se shkolles, (oborrit) deri brenda salles , ne meter gjatesi llogariten edhe pjeset fazonike .	m'	20	5.93	1.07	7.00	140.00 €



8.8	Blerja, transporti dhe montimi i lavabove .	cope	8	84.75	15.25	100.00	800.00 €
8.9	Blerja, transporti dhe montimi i baterive te lavabove .	cope	8	8.47	1.53	10.00	80.00 €
8.1	Blerja, transporti dhe montimi i pasqyreve te lavabove .	cope	8	8.47	1.53	10.00	80.00 €
8.11	Blerja, transporti dhe montimi i mbajteseve të letrave higjienike për lavabo .	cope	8	4.24	0.76	5.00	40.00 €
8.12	Blerja, transporti dhe montimi i WC vaskave komplet prodhuesi HANSGROHE .	cope	6	84.75	15.25	100.00	600.00 €
8.13	Blerja, transporti dhe montimi i mbajteseve te letrave te toaletit .	cope	6	4.24	0.76	5.00	30.00 €
8.14	Blerja, transporti dhe montimi i pisoareve komplet .	cope	4	84.75	15.25	100.00	400.00 €
8.15	Blerja, transporti dhe montimi i tush kabines me mbajtës sapuni	cope	1	127.12	22.88	150.00	150.00 €
8.16	Blerja, transporti dhe montimi i baterise së tush kabines me shoshë, montimi në murë, art. #31761 dhe #28492 HANSGROHE	cope	1	33.90	6.10	40.00	40.00 €
8.17	Shqyrtimi i funksionimit te rrjetit te kanalizimit (komplet) dhe funksionalizimi i tij ne rast te ndonje mbyllje te tij.	paushall	1	847.46	152.54	1000.00	1,000.00 €
Punët e Ujësjetit dhe Kanalizimit:							3,797.90 €
9	Punët e Tjera:						
9.1	Furnizimi dhe vendosja e rrjetave mbrojtese qe sherbejne per mbrojtjen e dritareve nga demtimi ne hapësiren e salles.	cope	8	84.75	15.25	100.00	800.00 €
9.2	Ndrrimi i xhamit te thyer ne nje dritare te salles.	cope	1	84.75	15.25	100.00	100.00 €



9.3	Furnizimi dhe vendosja e gypit adekuat nga kaldaja deri brenda salles per furnizim me uje te ngrohje te rrjetit ekzistues me diameter 2.5 coll . Gypi te vendoset ne te njejtin kanal qe do te hapet per nderrimin e gypit ekzistues (te demtuar) te kanalizimit te salles.	m'	30	16.95	3.05	20.00	600.00 €
9.4	Furnizimi dhe vendosja e termokonvertoreve te ri ne te njejtat pozita me ata ekzistues dhe te jene me mbrojtje adekuate nga goditjet.	cope	5	8.47	1.53	10.00	50.00 €
9.5	Te testohet rrjeti ekzistues i salles per ngrohje dhe te funksionalizohet .	paushall	1	466.10	83.90	550.00	550.00 €
9.6	Te behet shenjezimi me ngjyre adekuate i fushes se lojes per basketboll, volejboll, hendboll dhe futboll sipas normave.	paushall	1	847.46	152.54	1000.00	1,000.00 €
9.7	Te parashihet dhe ekzekutohet forma e perforcimit te pajisjeve per loje (portat, shtyllat metalike etj.) ne dyshemene e salles.	paushall	1	127.12	22.88	150.00	150.00 €
9.8	Te riparohet pjesa e demtuar e fasades se salles.	paushall	1	338.98	61.02	400.00	400.00 €
Punët e Tjera:							3,650.00 €
10	Punët e pa Parashikuara:						
10.1	Per punet e paparashikuara ne shumen deri ne 5% te vleres investive te cilat mund te dalin vetem pas demolimit dhe fillimit te punimeve per renovim . (Te aprovuara dhe nenshkruara nga inxhinieri mbikeqyres.)	paush	5% shumes investive	2767.54	498.16	3,265.70 €	3,265.70 €
Punët e pa Parashikuara :							3,265.70 €



REKAPITULLIMI PËR TE GJITHA POZICIONET PËR LLOTIN E I-rë.		
1	PUNËT E DEMOLIMIT	7,496.00 €
2	PUNËT E DYSHEMËSË	25,575.00 €
3	PUNËT E SUVATIMIT	3,120.00 €
4	PUNËT E ZDRUKHTARISË	6,200.00 €
5	PUNËT KERAMIKËS	5,500.00 €
6	PUNËT E NGJYROSJESË	6,150.00 €
7	PUNËT E ELEKTRIKËS	3,825.00 €
8	PUNËT E UJËSJELLSIT DHE KANALIZIMIT	3,797.90 €
9	PUNËT TJERA	3,650.00 €
10	PUNËT E PA PARASHIKUARA	3,265.70 €
	Gjithsejt TOTALI me TVSH :	68,579.60 €

DENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI OE:	NNP "B-ENGINEERING"
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE O.E.	BETIM MAMAJ
NENSHKRIMIDHEVULA	
DADAT: 08/06/2022	08.06.2022 



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 105322

Për **KK Mitrovica**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Betim Mamaj B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Renovimi i objektit të SHFMU-se SKENDERBEU në Vaganice-Lot1**
Nr. prokurimit: 642-22-4341-5-2-1 , Nr. brendshëm: 642/22/014/521

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **6,857.96€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **6,857.96€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyt ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 120 ditë kalendarike prej **10.08.2022** deri më **08.12.2022**

Data lëshimit: 09.08.2022

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni



Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: 105322

Kontraktuesi

Emri	Betim Mamaj B.I.
Përfaqësuar nga	Betim Mamaj
Adresa	Suhareka, Brigada 123
Nr i Biznesit	811039123
Telefoni	044416083

Përfituesi

Emri	KK Mitrovice
Adresa	MITROVICE

Garantuesi

Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB

Mbulueshmëria e Polices

Shuma Siguar	6,857.96
Periudha Sigurimit	10.08.2022 - 08.12.2022
Primi	123.44
Tvsh	22.22
Primi Bruto	145.66
Data e lëshimit	09.08.2022 15:26

Aktiviteti Ekonomik:

Renovimi i objektit te SHFMU-se SKENDERBEU ne Vaganice-Lot1

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësoje çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për policia të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave – pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Leudona Balaj - 2569



Përfaqësuesi i të siguarit
Betim Mamaj